



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

---

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u mbështetur në nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.31 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më \_\_\_\_\_ miraton këtë:

**RREGULLORE NR. \_\_\_\_/2023**  
**PËR ZYRËN PËR RIKTHIMIN E ASETETEVE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Me këtë rregullore themelohet Zyra për Rikthimin e Aseteve dhe përcaktohet organizimi, mënyra e punës, veprimtaria dhe kompetencat e saj.
2. Zyra për Rikthimin e Aseteve do të ofrojë ndihmë dhe këshilla në gjurmimin e pasurisë, bashkëpunimin me institucione financiare, kontabilitet forenzikë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për arritjen e synimeve të prokurorëve të rastit për kthimin e pasurisë së fituar përmes veprës penale.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha nivelet e organizimit të Prokurorit të Shtetit, njësisve përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe nga zyrtarët e angazhuar në këtë zyrë.

**Neni 3**  
**Përkufizimet dhe shkurtesat**

1. Përkufizimet dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 Këshilli - nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës;
  - 1.2 PSH- nënkupton Prokurorin e Shtetit;
  - 1.3 KPSH - nënkupton Kryeprokurorin e Shtetit;
  - 1.4 PK – Policia e Kosovës;
  - 1.5 NJIF – nënkupton Njësinë për Inteligjencë Financiare;
  - 1.6 ATK – nënkupton Administratën Tatimore të Kosovës;
  - 1.7 Dogana – nënkupton Doganën e Kosovës dhe
  - 1.8 PSV – Procedura Standarde të Veprimit.

**Neni 4**  
**Themelimi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve**

1. Zyra për Rikthimin e Aseteve themelohet në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
2. Këshilli siguron hapësirë të mjaftueshme për të akomoduar zyrtarët e angazhuar në Zyrën për Rikthimin e Aseteve dhe merr përsipër nevojat administrative të kësaj zyre.

## Neni 5 Kompetencat e Zyrës për Rikthimin e Aseteve

1. Zyra shërben për dhënien e ndihmës, sipas kërkesës së prokurorëve të rastit, në lidhje me veprimet hetimore sa i përket gjurmimit dhe identifikimit të asetëve, përfshirë asetet në shtetet e huaja apo asetëve të shteteve të huaja që gjenden në Kosovë, me qëllim përfundimtar të rikuperimit të këtyre asetëve. Zyra iu ofron ndihmë prokurorëve të rastit në procesin e:
  - 1.1 gjurmimit të asetëve përmes mbledhjes së të dhënave inteligjente dhe provave;
  - 1.2 ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve;
  - 1.3 bashkëpunimit ndërkombëtar,
  - 1.4 procedurave gjyqësore,
  - 1.5 ekzekutimit të urdhrave dhe
  - 1.6 kthimit të asetëve.
1. Zyra mbledh informata dhe të dhëna inteligjente qoftë nga regjistri zyrtar apo nga burimet e hapura, të cilat mund të shfrytëzohen nga prokurorët për të marrë informata nëpërmjet kanaleve zyrtare, të cilat mund të përdorën si prova në gjykatë.
2. Zyra mund të përdorë softuer financiar të avancuar dhe të bazave të të dhënave për të gjurmuar pasuritë që mund të kenë lidhje me aktivitete të paligjshme, duke përfshirë të dhëna në lidhje pasuritë e mbajtura në llogaritë bankare jashtë vendit, pasuri të paluajtshme, mallra luksoze dhe të ngjashme.
3. Zyra promovon dhe kontribuon në ngritjen e mekanizmave për sinjalizuesit për të raportuar pasuritë e dyshimta, duke siguruar anonimitetin dhe mbrojtjen e tyre.
4. **Zyra bashkëpunon me institucione financiare, përfshirë bankat vendore dhe ndërkombëtare, për të zbuluar transaksione të dyshimta, veçanërisht ato që mund të lidhen me pastrim parash ose aktivitete të tjera të paligjshme financiare.**
5. Zyra promovon hetimet financiare si pjesë të hetimit penal, duke nxitur ngritjen e kapaciteteve dhe aftësimin e vazhdueshëm profesional të zyrtarëve të deleguar në këtë zyrë dhe përmes angazhimit të kontabilistëve forenzikë për të hulumtuar të dhënat komplekse financiare, duke siguruar që origjina dhe lëvizjet e pasurive të jenë transparente.
6. Zyra zhvillon Procedurat Standarde të Veprimit për komunikimin zyrtar me agjencitë e tjera, të cilat nuk kanë zyrtarë të deleguar në Zyrë dhe PSV-të për ndërveprimin ndërmjet zyrës dhe prokurorëve të rastit, me qëllim të dhënies së ndihmës.
7. Zyra mban trajnime të kohëpaskohshme për prokurorët dhe zyrtarët e agjencive ligjzbatuese në lidhje me fushëveprimin e saj dhe mënyrat e ndihmës në rastet konkrete.
8. Zyra mban kontakte të rregullta dhe shkëmben përvoja me zyrat e kthimit të asetëve në shtetet e tjera dhe do të jetë agjenci e kontaktit për Rrjetin Rajonal të Rikuperimit të Asetëve Ndërinstitucionale (CARIN), në funksion të kthimit të pasurive në vende të tjera, si dhe për të hetuar aktivitetet financiare ndërkufitare.

## **Neni 6** **Përbërja e Zyrës**

1. Zyra përbëhet nga së paku një (1) prokuror i shtetit dhe zyrtarët e deleguar nga agjencitë ligjzbatuese, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.
2. **Udhëheqës i Zyrës është Prokuror i Shtetit, i caktuar me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit.**
3. Agjencitë ligjzbatuese delegojnë zyrtarët e tyre në zyrë pas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të nënshkruar ndërmjetit secilit institucion dhe Kryeprokurorit të Shtetit. Agjencitë ligjzbatuese që delegojnë zyrtarë në zyrë përfshijnë:
  - Policinë e Kosovës;
  - Njësitin për Inteligjencë Financiare;
  - Agjencinë për Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara dhe Sekuestruara;
  - Administratën Tatimore të Kosovës dhe
  - Doganën e Kosovës.
4. Kryeprokurori i Shtetit mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi edhe me institucione e tjera në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm dhe avancimit të zyrës.
5. Zyrtarët e deleguar nga agjencitë ligjzbatuese, të përcaktuar me nenin 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, sa i përket aspektit administrativ, mbesin zyrtarë me të drejta dhe detyrime të plota ndaj institucionit delegates. Kurse, sa i përket aspekti operativ, më saktësisht në lidhje me aktivitetet e bëra në kuadër të fushëveprimtarisë së zyrës i përgjigjen dhe i raportojnë vetëm Udhëheqësit të Zyrës.
6. Këshilli apo ZPSH-ja mund të caktojë zyrtarë administrativë shtesë në zyrë për të dhënë ndihmë administrative-teknike.

## **Neni 7** **Përgjegjësitë e Udhëheqësit të Zyrës**

1. Udhëheqësi i Zyrës është përgjegjës për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në kuadër të zyrës dhe shërben si pikë kontakti për Rrjetin Ndërinstitucional të Rikuperimit të Aseteve – CARIN.
2. Udhëheqësi i Zyrës ka këto përgjegjësi:
  - 2.1 Mbikëqyrë zyrtarët, duke përfshirë zyrtarët e deleguar, për të siguruar lehtësimin e komunikimit ndërmjet zyrës dhe prokurorëve.
  - 2.2 Përfaqëson zyrën në koordinimin e aktiviteteve me organet dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë.
  - 2.3 Siguron analiza të hollësishme dhe këshilla profesionale për të gjithë zyrtarët e rikuperimit të asetëve dhe prokurorët e rastit.

3. Udhëheqësi i Zyrës mban kontakte të rregullta me prokurorin e rastit dhe e mban të informuar rregullisht në lidhje me zhvillimet e veprimeve të zyrës në funksion të gjurmimit dhe identifikimit të aseteve.

4. Udhëheqësi i Zyrës i raporton me shkrim çdo tre (3) muaj Kryeprokurorit të Shtetit në lidhje me rastet që zyra ka ndihmuar prokurorët apo të dhënat që ka ndarë me shtetet e tjera.

5. Mandati i Udhëheqësit të kësaj zyre është tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësitë e zyrtarëve të deleguar nga Policia e Kosovës**

1. Zyrtarët policorë të deleguar nga Policia e Kosovës ndërmarrin secilin veprim hetimor të autorizuar nga Udhëheqësi i Zyrës, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve policore. Këto aktivitete policore përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1 kryerjen e hetimeve për krimet financiare dhe aktivitetet e paligjshme që çojnë në gjurmimin dhe identifikimin e pasurive;
- 1.2 kryerjen e analizës financiare, për të gjurmuar lëvizjen e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme dhe përmes transaksioneve financiare komplekse, përfshirë rastet ndërshtetërore;
- 1.3 përmes Udhëheqësit të Zyrës bashkëpunojnë me prokurorët e rastit për të marrë urdhrat e nevojshëm dhe urdhrat e gjykatës dhe
- 1.4 sigurohen që secili veprim të jetë brenda kufijve të ligjit dhe t'i përmbahen kërkesave strikte procedurale.

## **Neni 9**

### **Përgjegjësitë e zyrtarëve të deleguar nga NJIF-i**

1. Zyrtarët e deleguar nga NJIF-i ndërmarrin secilin veprim të autorizuar nga Udhëheqësi i Zyrës, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve që bien në fushëveprim të NJIF-it. Këto aktivitete përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1 analizimin e transaksioneve financiare dhe të dhënave për të identifikuar modele dhe aktivitete të dyshimta përmes përdorimit të mjeteve dhe teknikave të sofistikuar për të gjurmuar rrjedhën e fondeve që lidhen me aktivitetet kriminale;
- 1.2 mbledhjen dhe përpilimin e informacioneve nga burime të ndryshme, duke përfshirë raportet analitike strategjike të NJIF-it, institucioneve financiare, organeve rregullatore, agjencitë të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe

- 1.3 përmes Udhëheqësit të Zyrës inicion dhe/ose rekomandon lëshimin e urdhrave të ngrirjes ose urdhrave të konfiskimit për të parandaluar shpërndarjen e aseteve të lidhura me aktivitete kriminale.

### **Neni 10**

#### **Përgjegjësitë e zyrtarëve të deleguar nga ATK-ja**

1. Zyrtarët e deleguar nga ATK-ja ndërmarrin secilin veprim të autorizuar nga Udhëheqësi i Zyrës, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve që bien në fushëveprim të ATK-së. Këto aktivitete përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1 kryerjen e kontrolleve tatimore dhe rishikimeve financiare të individëve dhe bizneseve, duke u bazuar në ligjet që rregullojnë taksat dhe tatimet dhe
- 1.2 vënien në dispozicion të Zyrës së deklaratave tatimore, pasqyrave financiare dhe dokumenteve të tjera përkatëse, që mund të japin informacione për shpërdorimin e mundshëm të aseteve.

### **Neni 11**

#### **Përgjegjësitë e zyrtarëve të deleguar nga Dogana**

1. Zyrtarët e deleguar nga Dogana ndërmarrin secilin veprim të autorizuar nga Udhëheqësi i Zyrës, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve që bien në fushëveprim të Doganës. Këto aktivitete përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1 zbulimin e aktiviteteve të kontrabandës dhe skemave të pastrimit të parave të bazuara në tregti;
- 1.2 angazhohen në profilizimin dhe shenjëstrimin e rrezikut, duke përdorur të dhënat inteligjente nga Dogana për t'u fokusuar në individë dhe biznese, me fokus në gjurmimin dhe identifikimin e aseteve dhe
- 1.3 përmes Udhëheqësit të Zyrës inicion dhe/ose rekomandon lëshimin e urdhrave për të sekuestruar kontrabandën dhe mallrat e blera në rrugë të paligjshme.

### **Neni 12**

#### **Përgjegjësitë e zyrtarëve të deleguar nga agjencitë e tjera**

2. Zyrtarët e deleguar në Zyrë, që nuk i kanë të përshkruara përgjegjësitë e parapara me këtë nen, ato përgjegjësi do të specifikohen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Kryeprokurorit të Shtetit dhe institucionit përgjegjës, të nënshkruar në bazë të nenit 6, paragrafit 3 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 13**

#### **Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të angazhuar në Zyrë**

1. Udhëheqësit të Zyrës dhe zyrtarëve të angazhuar në zyrë do t'u mundësohen trajnime sistematike profesionale në ngritjen e shkathtësive në forenzikë financiare, shkathtësi për krimet kibernetike dhe në instrumente ndërkombëtare juridike sa i përket rikuperimit të aseteve.
2. Trajnim i specializuar do t'u mundësohet edhe në përdorimin e platformës elektronike, të zhvilluar sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 14**

#### **Platformat elektronike**

Zyra shërbehet me platforma elektronike, të cilat do të bëjnë menaxhimin e rasteve dhe shkëmbimin e informatave në mënyre të sigurt dhe të enkriptuar.

### **Neni 15**

#### **Komunikimi dhe protokoli standard i veprimit**

1. Zyra do të mundësojë komunikim të papenguar me të gjitha agjencitë ligjzbatuese në Kosovë dhe do të zhvillojë PSV-të për të lehtësuar komunikimin e brendshëm mes zyrtarëve të zyrës dhe në mes të zyrës dhe prokurorëve të rastit.
2. PSV-të e përcaktuara në paragrafin e mësipërm miratohen jo më pak se tre (3) muaj pas funksionalizimit të plotë të zyrës nga Kryeprokurori i Shtetit.
3. PSV-ja do të përcaktojë mënyrën, formën dhe llojet e akteve që zyra do t'i marrë në kuadër të fushëveprimtarisë së saj.

### **Neni 16**

#### **Konflikti i interesit**

1. Pjesëtarët e zyrës janë të obliguar të deklarojnë nëse ekziston konflikti i mundshëm i interesit për çështjet të cilat ndihmojnë prokurorët e rastit. Në rast se ekziston konflikti i interesit atëherë janë të obliguar që menjëherë të njoftojnë Udhëheqësin e Zyrës.
2. Udhëheqësi i Zyrës, me vendim në formë të shkruar, duke treguar arsyet, është i obliguar të zëvendësojë pjesëtarët e zyrës në rast se konstaton se ekziston konflikti i interesit vetëm për atë çështje në fjalë.

### **Neni 17**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje dhe funksionalizimit të plotë të zyrës bëhet nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese dhe delegimin e zyrtarëve në zyrë.

2. Deri në aftësimin e plotë të zyrtarëve, Zyra do të asistohet nga Instituti i Bazelit për Qeverisje, që do të mundësohet përmes zgjerimit të fushëveprimit së Marrëveshjes aktuale të Bashkëpunimit që KPSH-ja ka lidhur me Institutin e Bazelit për Qeverisje.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më \_\_\_\_\_

Jetish Maloku,  
Kryesues, Këshilli Prokurorial i Kosovës